



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar" *(Komision për dhenie mendimi)*

2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11235, datë 23.07.2019 "Për kthimin e ligjit nr. 42/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar" *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuz dhe Halit Valteri.

Mungojnë:

Arben Pëllumbi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Thimjo Plaku - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Bledar Karoli – Përgjegjës sektori në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Elson Thana - specialist në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Adelina Greca - Drejtoreshë Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Alisa Ramollari – Drejtoreshë në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit

Bledar Dervishaj – Këshilltari ligjor i Presidentit

Krisilda Fana – Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Duke uruar që të keni kaluar sa më mirë pushimet, si dhe uruar punë të mbarë në sesionin që po fillojmë sot, nisim me rendin e ditës!

Kujtim Gjuzi – Më falni, zoti kryetar, a mundem!

Niko Peleshi – Po, urdhëroni!

E keni për procedurë?

Kujtim Gjuzi – Po.

E para, jemi 15 minuta me vonesë, sipas orës sime, e dyta, unë do ta braktis sot mbledhjen e komisionit për arsye se dje Kryetari i Kuvendit nuk ka lejuar që opozita të flasë, megjithëse ne kishim regjistruar emrat.

Kjo është deklarata ime për sot.

Nuk kam asgjë me ju, si kryetar komisioni, as me kolegët këtu, këtë e kam vetëm me Kryetarin e Kuvendit, i cili dje ka treguar se është një monist i pandreqshëm.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Vazhdojmë me mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Sot është data 3 shtator dhe është mbledhja e parë e këtij komisioni.

Për shqyrtim dhe miratim kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar”. Relator është caktuar zoti Besnik Baraj.

Kemi të ftuar zëvendësministrin e Energjisë dhe Infrastrukturës, zoti Artan Shkreli dhe përfaqësuesit e ministrisë zoti, Thimjo Plaku, zoti Bledar Karoli dhe zoti Elson Thana.

Relatori do të thotë dy fjalë në hyrje, më pas do të flasin përfaqësuesit e ministrisë dhe do të vijojmë me pyetje-përgjigje, diskutime dhe, në fund, votimin.

Fjala për ju, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Përpara se të bëj ndonjë pyetje, do të them dy fjalë. Pa dyshim që ratifikimi i kësaj marrëveshjeje luan rol në forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve në këtë sektor, që ka një rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit. Nga ana tjetër do të doja të tërhiqja vëmendjen, në kuadrin e gjithë këtyre ratifikimeve që bëjmë, për rritjen e potencialeve, kapaciteteve të monitorimit dhe të mundësisë së ndërhyrjeve për rastet emergjente. Në nenin 8 flitet për incidentet që mund të ndodhin, fatmirësisht ne nuk kemi pasur në zonën tonë bregdetare incidente që kanë një efekt të rëndësishëm në mjedis dhe në cilësinë e ujërave bregdetare

ndonëse, herë pas here, vëmë re që plazhet tona ndoten dhe ne shohim derdhje të mbetjeve të ndryshme, të cilat grumbullohen dhe shihen e ndihen edhe nga pushuesit.

Nga ana tjetër, lidhur me forcimin e kapaciteteve për të bërë ndërhyrje për minimizimin e aksidenteve të ndryshme, do të thosha se nuk e di realisht se çfarë mundësish ofrojmë si vend, por shpeshherë këto janë aq serioze sa as vende shumë të zhvilluara nuk i përballojnë dot. Unë kam pasur rastin të marr pjesë në monitorimin dhe minimizimin e një aksidenti, që ka ndodhur shumë larg Shqipërisë në një zonë bregdetare, ku një vend i madh nuk kishte kapacitetet për të menaxhuar një situatë të rëndë dhe iu desh të merrte ndihmë nga vendet e tjera. Pa dyshim që një rast i ngjashëm në një zonë kaq të mbyllur siç është Mesdheu, do të sillte pasoja shumë të rënda. Në këtë kuadër, dua të ndërgjegjësoj sado pak në drejtim të rritjes së këtyre kapaciteteve, për të përballuar aksidente të mundshme.

Unë kam një pyetje. Vihet re që marrëveshja është miratuar në parim në vitin 2015. Për kuriozitet, dua të di se cila është arsyeja që zgjat kaq shumë? Kanë kaluar 4 vjet dhe tani sillet në Kuvend për t'u ratifikuar.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Shkreli, një prezantim të shkurtër të marrëveshjes dhe një përgjigje për zotin Baraj.

Artan Shkreli – Në lidhje me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar”, për kë do të dijë, shteti i Katarit, është një gadishull shumë i vogël në gadishullin e madh Arabik, me qasje në Gjirin Persik me një *per capita* të GDP-së sa 10-fishi ynë, është një vend shumë i zhvilluar, si të gjitha vendet që kanë qenë nën perandorinë britanike, por që u shkëput në vitet '70. Ne po nënshkruajmë për herë të parë një marrëveshje me këtë vend dhe ndoshta sepse për një “nxitim” të saj është bërë fakti që ka ardhur anija e njërit prej princave trashëgimtar të kurorës së Katarit. Në njëfarë mënyrë u vu re që lundrimi i jahtit të tyre nuk ishte, si të thuash, në bazë të një marrëveshjeje të ratifikuar. Në këtë pikëpamje, nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, përveç faktit që është marrëveshje kuadër, e cila nuk sjell asgjë të re në raport me marrëveshjet që kemi me vendet e tjera, pra nuk ka ndonjë nën shtesë, apo një specifikë, fut në hartën gjeografike të flotës sonë edhe këtë vend me të gjithë potencialin që ka dhe *vice versa*, pra i jep akses flotës së Katarit të lundrojë në brigjet tona sipas marrëveshjes së lundrimit të lirë.

Nuk dua të zgjatem me pikat e marrëveshjes, sepse janë standarde, nuk ka efekt financiar për buxhetin e shtetit dhe nuk është pjesë e *acquis communautaire*, pra e akteve të përafrimit të legjislacionit me BE-në dhe, për këtë arsye nuk kemi tabela përmbledhëse që duhen plotësuar. Problemi që ngriti zoti Bare, deputeti që, për fat të mirë, merret me

problemet mjedisore, pasi Shqipëria është në një moment, ku po has probleme të tilla jo vetëm me nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si rezultat i intensifikimit dhe shtimit të efektit të marrëveshjeve të ndryshme që bëjmë, unë nuk e njoh shumë mirë, prandaj kam specialistin këtu. Di që ka VKM, të cilat rregullojnë këto çështje, pjesërisht kodet detare (që nuk janë pjesë e ligjit tonë), si dhe VKM-në përkatëse. Nëse do të duhet një shpjegim i hollësishëm, mund t'ia kaloj fjalën kolegut, i cili mbulon fushën.

Pjesa tjetër është kontributi në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta ekonomike. Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik, sikurse e thashë edhe më përpara, pra vjen jashtë programit të parashikuar të Këshillit të Ministrave për vitin 2019.

Marrëveshja i shërben forcimit të marrëdhënieve të dy vendeve në fushën e transportit detar mbi bazën e parimeve të lundrimit të lirë, duke pasur parasysh parimet e barazisë, bashkëpunimit dhe përfitimeve të ndërsjella. Mbështetet mbi të gjitha kartat dhe konventat ndërkombëtare të OKB-së dhe akte të tjera, të cilat ne i kemi pranuar, por dhe reflekton në mënyrë besnike të gjithë legjislacionin tonë në fuqi, qoftë atë të përgjithësuar, qoftë atë që ka të bëjë me fushën e lundrimit detar.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin e datës 15 prill 2015, që e tha edhe zoti Baraj. Këto vite kanë ngelur pa ardhur në parlament, pasi aksioni diplomatik nuk e ka shoqëruar *mot à mot* këtë lëvizje që është bërë, pra vullneti nga pala tjetër ka qenë më i vonuar, por natyrisht ne e kemi bërë pjesën tonë. Siç e thashë, u desh vizita e një udhëheqësi të lartë të shtetit përkatës që ky mekanizëm, edhe nga ana e tyre, të bënte të mundur sjelljen e marrëveshjes këtu.

Pak a shumë këto doja të thosha. Nëse doni të hyj në nene të veçanta të marrëveshjes, siç mund të jenë zgjidhjet e mosmarrëveshjeve, mund ta bëj, por sikurse e thashë është marrëveshje kuadër, në kuptimin që nuk ndryshon nga të gjitha marrëveshjet e miratuara deri sot.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Shkreli!

A ka pyetje, komente apo diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Hedhim në votim parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Kush është dakord me nënin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nënin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shumë faleminderit, përfaqësuesve të ministrisë!

Besoj se do të jeni të pranishëm edhe për pikën tjetër të rendit të ditës, diskutimin e të cilit do ta fillojmë tani, mbase dhe miratimin e tij, nëse do t'i shkojmë deri në fund!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.09.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11235, datë 23.07.2019 "Për kthimin e ligjit nr. 42/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar"" (Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuz dhe Halit Valteri.

Mungojnë:

Arben Pëllumbi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Elson Thana - specialist në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Adelina Greca - Drejtoreshë Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Alisa Ramollari – Drejtoreshë në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit

Bledar Dervisha – Këshilltar ligjor i Presidentit

Krisilda Fana – Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike.

Niko Peleshi – Tani kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11235, datë 23.07.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar””.

Data e ardhjes në Kuvend i këtij dekreti është 24.07.2019 dhe do të shqyrtohet në seancë të enjten tjetër, pra në datën 12 shtator. Relatore është zonja Eglantina Gjermani, e cila do të bëjë një prezantim të shkurtër, pastaj do të vazhdojmë me procedurën.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit të planifikimit dhe zhvillimin e territorit, Presidenti ka paraqitur disa arsye ku argumenton kthimin për rishqyrtim të ligjit, që lidhen me ndryshimet në nenin 8 për mundësitë e rishikimit e kushteve të lejes, apo ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi.

Presidenti arsyeton se rishikimi i kushteve të lejes së ndërtimit dhe i projektit të zbatimit pa dijeninë dhe pëlqimin e pronarëve të pasurisë pronë private, mbi të cilën realizohet ndërtimi, nëse do të aplikoheshin sipas ndryshimeve që kemi miratuar si parlament, në një sipërmarrje private do të përbënin cenim të parimit të sigurisë juridike. Në fakt, edhe me ndihmën e këshilltarëve ligjorë në parlament, si dhe me konsultimet që kemi bërë me Ministrinë e Infrastrukturës, argumentet që paraqesim janë si më poshtë:

Lidhur me këtë shqetësim të Presidentit, në mënyrë eksplicite për cenimin e sigurisë juridike, mund të thuhet se, ndryshimet që ne, si Kuvend, kemi miratuar në nenin 8 të ligjit, rishikimi i kushteve të lejes lidhen me saktësimin e termave “kushtet e lejes” e “projekti i zbatimit” dhe nuk synojnë bërjen e ndryshimeve në thelbin e nenit 48 të ligjit ekzistues, por t’i harmonizojnë të gjithë këta terma me termat që janë përcaktuar në rregulloren e zhvillimit të territorit, në mënyrë specifike në nenin 17 të VKM-së nr.408, që është miratuar në vitin 2015.

Për detajet teknike besoj se do të na ndihmojë ekipi i ministrisë, por dua të theksoj se mundësia e rishikimit të tyre nga autoriteti që ka marrë lejen, mbi kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, aktualisht, është e parashikuar nga neni 48 i ligjit ekzistues në pikën 2 të tij dhe mbetet e pandryshuar që në kohën e miratimit të këtij ligji, pra që kur ligji për planifikimin e territorit është miratuar nga parlamenti shqiptar në vitin 2014. Madje, mund të thuhet se kjo dispozitë e ka kaluar edhe testin e kushtetutshmërisë, për sa kohë nuk është goditur nga Gjykata Kushtetuese apo në Gjykatën Kushtetuese.

Së dyti, në rastin e aplikimit të këtij procesi brenda një sipërmarrjeje private, siç arsyetohet në dekretin e Presidentit, rregullimi i marrëdhënies juridiko-civile midis pronarit të truallit dhe investitorit bëhet bazuar në parimin e lirisë kontraktuale, e cila përfshin dhe të

drejtën e tyre për ta rishikuar marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur mes tyre në rast se ndryshojnë kushtet.

Për këtë arsye, shprehja e vullnetit të pronarëve të truallit jo domosdoshmërisht duhet të jetë pjesë e parashikimeve ligjore, por mund të jetë e parashikuar si kërkesë në rregulloren e zhvillimit, e parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

Besoj se pas miratimit të ligjit do të ketë ndryshime edhe në rregulloren nr. 408 të zhvillimit të territorit.

Në dekret Presidenti shprehet edhe për procedurën e propozimit dhe miratimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave, për sa i përket procesit të konsultimit publik me ministritë e linjës apo grupet e interesit, duke arsyetuar se Kuvendi i Shqipërisë, si një institucion që duhet të ushtrojë kontroll dhe mbikëqyrje mbi veprimtarinë ekzekutive, kishte për detyrë të verifikonte nëse Këshilli i Ministrave kishte respektuar ose jo zbatimin e ligjit në procesin e konsultimit publik dhe bashkërendimit institucional, gjë që nuk e ka bërë, por e ka shqyrtuar projektligjin me procedurë të përsheptuar.

Është e vërtetë që ne si parlament e kemi kaluar, diskutuar dhe miratuar me procedurë të përsheptuar këtë ndryshim në ligjin për planifikimin e territorit, por unë, si relatore, në diskutimin që kemi bërë këtu dhe në prezantimin që është bërë nga ministria, disa nga pyetjet që i kam drejtuar ekipit të ministrisë kanë qenë për marrjen e mendimit të institucioneve të tjera dhe realizimin e konsultimit me grupet e interesit. Kam marrë përgjigje nga ministria. Kam rikonstatuar që ministria ka marrë mendime dhe është koordinuar me ministritë e linjës.

Besoj se për këtë do të japë një përgjigje më të detajuar zëvendësministri dhe ekipi i ministrisë.

Sa më sipër, mendoj se argumentet e paraqitura nga Presidenti në dekretin e tij, nuk janë të bazuara. Për këtë arsye i propozoj komisionit të votojë rrëzimin e këtij dekreti.

Ju faleminderit!

Pa dyshim, i mirëpres komentet dhe sugjerimet, që besoj se janë më shumë teknike, për dekretin e Presidentit dhe argumentet e tij.

Është për t'u mbështetur fakti që ndryshimet që kemi realizuar nuk cenojnë thelbin e neneve të ligjit ekzistues për planifikimin e territorit, për më tepër, bëhet fjalë për harmonizim terminologjie me vendimin nr.408 të Këshillit të Ministrave, që e citova më parë.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka pyetje për sqarim për përfaqësuesit e ministrisë? A ka komente apo diskutime?

Ju kujtoj se dekreti votohet pro ose kundër. Kështu që pas komenteve dhe diskutimeve tuaja, mirëpres edhe propozimet për t'i hedhur në votim.

Urdhëroni, zoti Shtjefni...

Zef Shtjefni – Zoti kryetar, mendoj se përfaqësuesit e ministrisë duhet të na shpjegojnë diçka. Këshilltarët e Presidentit, këshilltari juridik, që e kanë kthyer ligjin, janë bazuar në disa pika, që i shikoj këtu, por duke mos pasur kohë për t'i marrë një nga një, meqë janë edhe specialistët këtu, të na shpjegojnë se ku ka ceduar ky ligj, që ne e miratuam një herë dhe pse e ka kthyer Presidenti. Janë disa pika që, nga ana teknike, po t'i marrim një nga një, ndoshta nuk i kuptoj mirë. Të na i shpjegojnë përfaqësuesit dhe ta marrim vesh si e mendojnë këta, se çfarë ka thënë Presidenti dhe çfarë thonë këta. Pastaj, nëse kemi ndonjë gjë konkrete, le ta themi.

Kaq kisha.

Niko Peleshi – A ka ndonjë pyetje tjetër? Përfaqësuesit e ministrisë t'i mbledhin pyetjet dhe të përgjigjen e radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Atëherë, vazhdojmë me përgjigjen e pyetjes së zotit Shtjefni.

Enea Karakaci – Përshëndetje!

Nëse e mbani mend, para disa muajsh, kur kemi sjellë projektligjin për disa ndryshime të këtij ligji, kishte disa dispozita përkatëse që kërkonin ndryshim.

Dekreti i Presidentit ka prekur vetëm njërën pikë, jo nene të tjera të ligjit, konkretisht, nenin 48 të ligjit përkatës. Arsyeja, që besoj se është e shprehur aty, le të themi, referon një pasiguri juridike, që pretendohet se mund të krijohet ndërmjet marrëdhënies juridike private (këtë duhet ta theksojmë), që krijohet ndërmjet pronarit të tokës dhe zhvilluesit të ndërtimit.

Ne duhet të sqarojmë që ne thelb neni 48 nuk ka për qëllim të vendosë një rregull të ri shqyrtimi të ndryshimit të lejes së ndërtimit. Aktualisht, ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit njihet si koncept, në bazë të VKM-së përkatëse të rregullore së zhvillimit të territorit dhe është e parashikuar në nenin 17 të kësaj rregulloreje, ku lejohet që gjatë ndërtimit të ketë ndryshime në projektin ekzistues të ndërtimit.

Në rastin konkret, duke qenë se ne ishim duke e rishikuar ligjin në disa dispozita, u pa e arsyeshme të bëhej një harmonizim ndërmjet parashikimit të VKM-së, që e njihte një koncept të tillë, si dhe konceptit të ligjit, të nenit 74, që nuk e parashikonte në tërësinë e tij.

Është e rëndësishme për t'u sqaruar se koncepti i nenit 48, në vetvete, nuk flet për ndryshim të sipërfaqes. Ndryshimi i sipërfaqes së ndërtimit (nëse do të ishim para një rasti të tillë) nuk është brenda nenit 48, por është parashikuar në nenin 11, germa “b”, të VKM-së së rregullore së zhvillimit të territorit, e cila ndryshimin e sipërfaqes e parashikon si një aplikim

për leje nga e para. Pra, duhet të hyjë edhe një herë për leje ndërtimi, për t'u shqyrtuar edhe një herë të gjitha praktikatat, dokumentacionet e të tjerë.

Ajo që referohet në nenin 48 është thjesht ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit, që nuk prek sipërfaqen e ndërtimit. Në këtë rast nuk jemi te cenimet, që dekret i Presidentit i parashikon...

Niko Peleshi – Po volumetria, a mund të ndryshojë? Pra, a bën pjesë te ndryshimet e lejuara apo...?

Alisa Ramollari – Sipas VKM-së nr.408 lejohet deri në 2% të sipërfaqes totale. Vetëm kaq. Nëse ka më tepër, aplikohet për leje të re, sipas nenit 11/b.

Niko Peleshi – Faleminderit për sqarimin!

A ka diskutime të tjera?

Po, zoti Valteri.

Halit Valteri – Përshëndetje të gjithëve!

Do të dal pak jashtë temës. Kur kemi pasur ligje për planifikimin e territorit, për investime ose për ratifikim marrëveshjesh, opozita ka qenë gjithmonë me *buonsens*. Gjatë gjithë kohës i ka aprovuar, sepse janë gjëra që ndikojnë në zhvillimin e vendit.

Tani, këta njerëz që përgatisin këto ligje, ky staf që keni, a ka mundësi të jenë më të aftë, më të përgjegjshëm, që të paktën të jenë seriozë në atë që bëjnë? Sepse vijmë këtu (jemi 20 burra e gra deputetë këtu, që firmosim, votojmë e miratojmë) dhe del dikush nga Presidenti i Republikës dhe gjen atë kleçkën që na mbledh prapë, për të shkelur atë që kemi miratuar më parë.

Për këto që na sqaroni ne, përgatisni shtojca, shkruajini aty: “Rregullon ky ligj, e miraton ky ligj, është ky 2-përqindëshi i sipërfaqes...” Sqarojini të gjitha para se të vijë një ligj. Kur ju nuk keni asnjë lloj pengese, pse i sillni gabim? Ose ju jeni joseriozë, ose ju dukemi ne joseriozë në punën që bëjmë! Kështu që, do t'ju lutesha shumë, herë tjetër të jeni më të saktë dhe më koncizë në punën që bëni!

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Valteri!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkesa është e arsyeshme për të pasur më shumë informacion, më shumë sqarim paraprak, në mënyrë që komisioni të mos marrë shumë kohë dhe të kemi mundësi të gjykojmë më mirë. Kjo është konstruktive. Mbajeni shënim dhe të jetë parasysh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përtej arsyeve teknike, politike... Kjo është tjetër çështje.

A ka diskutime të tjera?

Kemi propozimin e zonjës Gjermani, që është edhe relatore e këtij materiali, për rrëzimin e dekretit të Presidentit, bazuar tek arsyetimet për të cilat foli zonja Gjermani dhe përfaqësuesi ministrisë i shtjelloi në mënyrë shteruese.

Nëse ka pyetje të tjera, mund t'i bëni, por besoj se jemi të qartë.

Sipas procedurës, e hedhim në votim propozimin e zonjës Gjermani për rrëzimin e dekretit të Presidentit “Për kthimin e ligjit nr.42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar””.

Kush është dakord me propozimin për rrëzimin e dekretit të Presidentit? Kundër? 1 votë është kundër.

Miratohet propozimi i zonjës Gjermani për rrëzimin e dekretit të Presidentit për ligjin nr.42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar””.

Kjo ishte pika e dytë dhe e fundit e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni së shpejti.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA